



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA



Federata e Basketbollit
të Kosovës
+383 49 738 080
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Nr. 83
Str: Radovan Zogovic
10 000 Prishtina

Prishtinë, 4/10/2024

Komisioni i Garave të Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK), në bazë të kompetencave të dhëna me aktet normative të FBK-së, nën suaza të mandatit që ushtron, në mbledhjen e mbajtur me datë 04.10.2024, në përbërje prej: Armend Hamiti kryetar i KG, Arianit Shala anëtar i KG dhe Ismet Ferati anëtar i KG shqyrtoi dhe miratoi këtë:

VENDIM NR. 09/2024/25 I KOMISIONIT TË GARAVE

- I.** Komisioni i Garave ka shqyrtuar kërkesën e paraqitur nga Federata e Hendbollit të Kosovës për shtyrjen e një ndeshje të ProCredit Superliga Meshkujt, për shkak të ndeshjes raundit të dytë (final) të kualifikimeve për Kampionatin Evropian EURO 2026 në hendboll, në të cilën Kombëtarja e Kosovës (seniorët) do të takohet me Holandën, më 10.11.2024. në sallën 1 tetori Prishtinë.
- II.** Komisioni i garave pas shqyrtimit të kësaj kërkesë e duke pasur parasysh dhe interesin e përfaqësimit sa me të mirë të Republikës së Kosovës në arenën ndërkombëtare në të gjitha sportet, MIRATON kërkesën e paraqitur nga FHK.
- III.** Në këtë sallë me dt 09.11.2024 është paraparë të luhet ndeshja e ProCredit Superliga Meshkujt KB Bora - KB Sigal Prishtina e cila shtyhet për një datë tjetër që do të merren vesh klubet mes veti brenda afatit të parapare me Propozicionet e Garave .
- IV.** Vendimi hyn në fuqi nga data e publikimit

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA



Federata e Basketbollit
të Kosovës
+383 49 738 080
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Nr. 83
Str: Radovan Zogovic
10 000 Prishtina

ARSYETIM

Gjatë vendimmarrjes lidhur Vendimin Nr. 09/2024-25, Komisioni i Garave ka marrë parasysh faktet në vijim:

- Kjo kërkesë vjen si rrjedhojë e ndeshjes së raundit të dytë (final) të kualifikimeve për Kampionatin Evropian EURO 2026 në hendboll, në të cilën Kombëtarja e Kosovës (seniorët) do të takohet me Holandën, më 10.11.2024.
- Ndeshja është caktuar që të zhvillohet pikërisht në sallën "1 Tetori". Ku më date 08 nëntor është e domosdoshme të bëhet shtrimi i shtresës Gerflor në palestër, për t'i ofruar kushte optimale Kombëtares së Holandës për stërvitje.
- Nga kjo arsye kërkesa e FHK është e arsyeshme dhe Komisioni i Garave e miratoj.

Në emër të Komisionit të Garave të FBK-së,

Armend **HAMITI**
Kryetar i Komisionit



Federata e Basketbollit të Kosovës

KËSHILLË JURIDIKE:

Në pajtim me Nenin 45 të Propozicioneve të Garave për Kategoritë Seniore, Edicioni 2024/2025, në vendimin e Komisionit të Garave është e lejuar ankesa tek Komisioni i Arbitrazhit të FBK-së (si organ i shkallës së dytë), e cila dorëzohet më së voni 24 orë pas marrjes së vendimit. Për ankesë, paraqitësi i ankesës duhet të deponojë në llogarinë e FBK-së shumën prej 500.00 €.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:

